



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

HISTORIA E GREQISË

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë; 20 leks, 20 sem

Viti akademik: viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor” në Gjuhe letersi dhe qyteterim grek

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në rishprehjen në gjuhë të huaj të të gjitha të dhënave dhe materialeve me karakter historik mbi Greqinë, ku aktiviteti i tij mendor në përpunimin e mendimit kritik në rrethanat historike zë vendin kryesor. Shkathtësimi i të menduarit dhe të shprehurit në gjuhën e huaj mbi një bosht të përcaktuar ideor, formëson studentin në mbajtjen e një rendi logjik në ligjërimin e tij dhe në racionalitetin e përdorimit sa më të saktë të gjuhës greke. Përtej sa më sipër, studenti informohet me elementet e historisë përmes së cilave ka kaluar Greqia dhe se çfarë rezultatesh sollën faktet historike në popullin grek dhe në vendet fqinje.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte fillestare të historisë së Greqisë.
2. Aftësi për të komunikuar në situata të ndryshme jo shumë të vështira.
3. Njohuri mbi fakte historike.
4. Aftësi për të treguar për gjëra mjaft të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime.
7. Ky kurs synon në dëgjimin aktiv të studentit gjatë dhënies së leksionit, aktivizimin e tij dhe shprehjen e përgatitjes së aftësisë shprehëse në gjuhë të huaj, formësimin e idesë dhe trasmetimin e saj në gjuhë të huaj si dhe përpunimin e të dhënave dhe elementeve historike.